



DORACAK PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE REKLAMUESE NË LED PËR KLUBET E PROCREDIT SUPERLIGËS

Me qëllim të rritjes së vlerës së garës së ProCredit Superligës së Kosovës, por edhe rritjes së vlerës dhe përkrahjes së klubeve anëtare të saj, Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) do të vazhdoj që të sigurojë praninë e sistemit më të avancuar të reklamimit LED në të gjitha palestrat sportive, ku zhvillohen ndeshjet e elitës së basketbollit kosovar, dhe jo vetëm.

Përgjegjësitë e klubeve

Federata e Basketbollit të Kosovës do të vazhdoj të mbulojë shpenzimet e sistemit LED në emër të klubeve anëtare të ProCredit Superligës, ndërsa klubet nikoqire kanë përgjegjësi si vijon:

- Të sigurojnë hapësirën për vendosjen e pajisjeve LED në palestër.
- Të asistojnë në vendosjen e sistemit me kapacitetet e tyre njerëzore.
- Të garantojnë qasje të papenguar në palestër për ekipin realizues të kontraktuar nga FBK.
- Të sigurojnë hyrjen dhe daljen e sigurt të ekipit realizues.
- Të mbajnë përgjegjësi për dëmet e mundshme ndaj pajisjeve LED që shkaktohen nga ndonjë anëtar ose tifoz i tyre.
- Pas çdo ndeshje, dëmet do të dokumentohen nga zyrtarët e ndeshjes në FBK dhe nga ekipi i kontraktuar për vendosjen e sistemeve LED. Raporti i dëmeve do t'i përcillet klubit përkatës së bashku me obligimet financiare.

Afatet për dorëzimin e reklamave

Klubet duhet të dërgojnë reklamën e tyre në formatin e kërkuar nga FBK, **më së largu dy ditë para ndeshjeve**, për të siguruar aprovimin dhe ngarkimin e duhur në sistemin LED.

Formatet e pranueshme për reklamën janë:

- Video: MP4
- Fotografi: JPEG
- Dimensionet: 1535x256 pixels.
- Kohëzgjatja: 6-15 sekonda.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





- Reklammat duhet të jenë të kualitetit të lartë dhe të dorëzohen në kohë tek personi kontaktues i FBK-së për aprovimin përfundimtar.

Përgjegjësitë dhe pasojat

Në rast të dëmtimeve të sistemeve LED për shkak të veprimeve të ndonjë anëtarit të klubit, lojtari apo tifozëve, klubi përkatës do të mbajë përgjegjësi të plotë për mbulimin e kostos së riparimit ose zëvendësimit. Federata e Basketbollit të Kosovës do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të garantuar kompensimin financiar brenda afateve të përcaktuara.

Ndërveprimi dhe komunikimi

Federata e Basketbollit të Kosovës do të caktojë një person përgjegjës për menaxhimin e reklamave në sistemin LED. Klubet e ProCredit Superligës duhet të caktojnë gjithashtu një person përgjegjës për të koordinuar në mënyrë të vazhdueshme me FBK-në.

Për çdo çështje teknike apo operacionale, kontaktoni:

- **Personi Kontaktues i FBK-së:**

Dren Hasangjekaj – Zyrtar për Marketing

Email: marketing@basketbolli.com

Tel: +383 44 224 488

Këshilla për optimizimin e reklamave

Për të maksimizuar efektivitetin e reklamave tuaja në sistemin LED, rekomandojmë:

- Përdorni ngjyra të ndritshme dhe mesazhe të qarta.
- Mbani mesazhet e shkurtra dhe direkte, pasi koha e shfaqjes është e kufizuar.
- Përfshini logot në mënyrë të dukshme dhe harmonike.

Ndarja dhe organizimi i hapësirave reklamuese

Klubeve të ProCredit Superligës do t'ju ndahet tabela orientuese e reklamimit në sistemin LED, në të cilën duhet të identifikojnë të gjithë sponsorët që do të reklamohen në të.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Hapësira reklamuese në sistemin LED do të ndahet mes ekipeve nikoqire dhe FBK-së, në proporcionin e përcaktuar nga FIBA për garat elitare të saj. Klubet nikoqire do të kenë të drejtë të vendosjes së deri në 16 logo të sponsorëve të tyre, përfshirë edhe logot e komunave përkatëse në rast se të njëjtat përkrahin veprimtarinë e klubeve, ndërsa FBK ruan të drejtën e vendosjes së 8 reklamave të veta pas çdo rotacioni të 16 reklamave të ekipit nikoqir. Reklammat do të jenë të ndara mes vete me logot përkatëse të FBK-së dhe klubit nikoqir.

Përfundim

Vendosja e sistemeve LED për të gjitha ndeshjet e ProCredit Superligës përbën krijimin e një standardi të ri organizativ për garat e nivelit elitare në basketbollin kosovar. Për më shumë detaje dhe ndihmë të mëtejshme, kontaktoni ekipin tonë në FBK.

Shembull i një rotacioni në LED – 28 pozicione:

1. Intro klubi nikoqir	2. Sponsor	3. Intro FBK
4. Sponsor	5. Sponsor	6. Sponsor FBK
7. Sponsor	8. Sponsor	9. Sponsor FBK
10. Sponsor	11. Sponsor	12. Sponsor FBK
13. Sponsor	14. Sponsor	15. Sponsor FBK
16. Sponsor	17. Sponsor	18. Sponsor FBK
19. Sponsor	20. Sponsor	21. Sponsor FBK
22. Sponsor	23. Sponsor	24. Sponsor FBK
25. Sponsor	26. Outro klubi nikoqir	27. Sponsor FBK
		28. Outro FBK

Me respekt,

Elvira **DUSHKU**
Sekretare e Përgjithshme

Federata e Basketbollit të Kosovës



Prishtinë, 18.09.2024

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

